



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery		23-12-2022		viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSTHC	8426/2022		115	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.998/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.998/2022 të datës 11.11.2022 e bashkuar sipas Vendimit të Këshillit VK.Nr.189/2022 të datës 14.12.2022, në çështjen juridiko-administrative "kundërshtim i masës disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 23.12.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.998/2022 e datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesit
- II. *Anulohet* Vendimi me numër protokolli 040 i datës 26.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe **lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.**
- III. *Obligohet* Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit dhe që të gjithë të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më atë 11.11.2022 kanë parashtruar ankesë veç e

veç në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 040 të datës 26.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar përkatësisht jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar i ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesve bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjtë, në mbështetje të nenit 13 paragrafit 3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 8 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 9 paragrafit 2 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datë 14.12.2022 ka nxjerr Vendimin VK.Nr.189/2022 për bashkimin e lëndëve, ku ankesat e ankuesve janë bashkuar në ankesën me numër A.nr.998 /2022 të datës 11.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së janë plotësuar kushtet lidhur me pranueshmërinë e ankesën sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, administroi këto prova: Ankesën me numër protokoll 7026/2022 të datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

Kontratën për punë për kohë të pacaktuar e ankuesit e datës 04.07.2018; Rekomandimin për përtretje të kontratës i datës 01.06.2018;

Ankesën me numër protokoll 7026/2022 të datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

Procesverbali i datës 06.10.2022 i seancës së Komisionit Disiplinor për ankuesin

Kontratë pune për kohë të pacaktuar për ankuesin e datës 02.07.2018;

Ankesën me numër protokoll 7028/2022 të datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

Kontratë Pune për kohë të pacaktuar për ankuesin e datës 02.07.2018;

Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin e datës 29.12.2020 dhe

20.10.2022; Ankesën me numër protokoll 7029/2022 të datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratë Pune për kohë të pacaktuar për ankuesin e datës 02.07.2018; Procesverbalin e datës

06.10.2022 të seancës së Komisionit Disiplinor për ankuesin Ankesën me numër protokoll 7030/2022 të datës 11.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

Vendimin me numër protokoll 040 të datës 26.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Zarin e datës 09.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.11.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 24.11.2022 dhe 02.12.2022; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar për ankuesin

e datës 02.07.2018; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankueseve e datës 27.09.2022; Procesverbali i seancës së Komisionit Disiplinor i datës 06.10.2022; E-mailin e datës 26.09.2022 nga

për Emailin e datës 23.09.2022, 26.09.2022 nga për Emailin e datës 26.09.2022 nga për Urdhëresë për Sjellje

PKR.nr.202/21 e datës 29.08.2022; Lista e vajtje ardhje në punë e datës 23.09.2022; Shkresë nga Njësia për Transportin e të Burgosurve për bartjen e të burgosurve e datës 23.09.2022 nga Qendra e Paraburgimit në Gjilan në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nga Qendra e Paraburgimit në Gjilan në Gjykatën Themelore në Gjilan, nga Qendra e Paraburgimit në Prizren në Gjykatën Themelore në Prizren, nga Qendra e Paraburgimit në Prizren ne Spitalin Rajonale të Prizren, nga Qendra e Paraburgimit në Prizren në Gjykatën Themelore në Gjakovë; Urdhëresë PAKR.nr/400/2022 e datës 27.07.2022 nga Gjykata e Apelit e Kosovës për Qendrën e Paraburgimit në Gjilan; Kërkesë për sjelljen e paraburgosurve në Gjykatën Themelore në Prizren e datës 22.09.2022; Kërkesë për përcjellje e datës 22.09.2022; Raport i Spitalit të Përgjithshëm në Prizren i datës 23.09.2022; Shkresë nga Njësia për Transportin e të Burgosurve për bartjen e të burgosurve e datës 23.09.2022 nga Qendra e Paraburgimit në Prizren në Prokurorinë Themelore në Gjakovë; Kërkesë për sjellje të burgosurit në prokurori e datës 22.09.2022; Njoftimin përmes emailit i datës 01.12.2022 nga Vendimin me numër protokollit 1039 i datës 13.10.2022 dhe me numër protokollit 0139 i datës 11.02.2022 për themelimin e Komisionit Disiplinor; Vendimin VK.Nr.189/2022 të datës 14.12.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, vlerësoi që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale gjegjësisht sipas kontratave të punës për kohë të pacaktuar, është konstatuar se të gjithë ankuesit janë të punësuar në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në pozitën e punës *Zyrtar Korrektues*.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 28.09.2022, Udhëheqësi i Njësitit për Përcjelljen e të Burgosurve ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesve, për shkak të supozimit se të njëjtit me datë 23.09.2022, kanë qenë të obliguar të zbatojnë Urdhëresën me numër 8340/2022 të datës 23.09.2022 për përcjellje të burgosurve nga qendra e Paraburgimit në Prizren në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, dhe se pas përfundimit të seancës gjyqësore dhe dorëzimit të të burgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, kanë qenë dashur që të kthehen me kohë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren për të vazhduar punën deri në fund të orarit dhe duke marr parasysh intervalin kohor prej dorëzimit të të burgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan dhe kthimin e tyre në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, dyshohet se ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës sipas nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues i Kosovës më Vendimin me numër protokollit 040 të datë 26.10.2022 ka shpallur ankuesit përgjegjës veç e veç për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, duke shqiptuar ndaj ankuesve veç e veç masën disiplinore "ndalimi i 20% e pagës për periudhën një (1) muaj".

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 040 të datës 26.10.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendojnë se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerr më shkelje të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit

Nr.03/L-212 të Punës si dhe të parime themelore të shërbimit civil, dhe se në seancë dëgjimore Komisioni Disiplinor ka qenë në përbërja prej kryesues, dhe anëtarë, ndërsa, tek vendimmarrja kanë qenë kryesues, dhe Propozojnë që Këshilli të aprovoj si të bazuar ankesën dhe të anulohet Vendimin me numër protokoll 004/2022 të datës 26.10.2022 të Komisionit Disiplinor lidhur me shqiptimin e masës disiplinore " ndalim 20 % i pagës për periudhën prej një muaji".

Kolegji i Këshillit lidhur me pretendimin ankimore të ankuesve referuar përbërjes së Komisionit Disiplinor, ka analizuar provat e lëndës dhe rrjedhimisht ka gjetur së me Vendimin me numër protokoll 0139 të datës 10.02.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është themeluar Komisioni Disiplinor me mandat tre (3) vjeçar në përbërje nga kryesues, anëtar dhe anëtare, kurse më Vendimin me numër protokoll 139 të datës 13.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është shfuqizuar Vendimin me numër protokoll 0139 i datës 10.02.2022, dhe është themeluar Komisioni Disiplinor më përbërje nga: Zëvendësues i Drejtorit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë-Kryesues, Zyrtare e Burimeve Njerëzore-anëtare dhe Zyrtar Ligjor në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë-anëtar, me arsyetimin së ndryshimi i përbërjes së Komisionit bëhet për shkak së njëri nga anëtarët e komisionit i cili ka qenë në nivel profesionale ka kaluar në pozitë të nivelit drejtues. Me tej Kolegji nga vlerësimi i provave të lëndës konstaton së në kohën e inicimit të procedurës disiplinore me datë 28.09.2022 ka qenë në fuqi Vendimi me numër protokoll 0139 i datës 10.02.2022 mbi themelimin e Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa sipas nënshkrimeve në procesverbalin e seancës së datës 06.10.2022, Kolegji vëren se i njëjti është nënshkruar nga dhe pra ka marrë pjesë në seancë dëgjimore në cilësi të kryesuesit të Komisionit Disiplinor pa lëshim të Vendimit me numër protokoll 1039 të datës 13.10.2022, ndërsa vendimi i kundërshtuar me ankesë është nënshkruar nga në cilësi të kryesuesit, dhe -në cilësi të anëtarëve të Komisionit Disiplinor.

Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit, trajtimi i përgjegjësisë disiplinore të ankuesve nga Komisioni me përbërje të ndryshme të anëtarëve është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin përcaktohet se : 1. *Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.* 2. *Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj...* kështu që nisur nga rrethanat si më sipër, Kolegji në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton së një akt administrativ i nxjerr në mungesë të autorizimit nga një ligj dhe nga organi jo kompetent është akt i paligjshëm.

Andaj, sa me sipër dhe duke qenë se Vendimi me numër protokoll 040 i datës 26.10.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritorie lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar dhe rrjedhimisht vlerësoi që kjo çështje ankimore të kthehet në ri-

REKORD
BIRU JU MARRAZ
050

shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast të Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës i cili ka qenë i emëruar në kohën e inicimit të procedurës disiplinore, me detyrimin që i njëjti të rishqyrtoj çështjen në fjalë dhe të nxjerr vendim në pajtim me nenin 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Theksuar si me lart, Kolegji duke u bazuar ne nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.998/2022

Avdyll BEKTESHI

Behteshi
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve;
- Kryesueist të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.